

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Hashim Çollaku, kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi e Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.M. nga ...-Zubin Potok, Komuna e Mitrovicës, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par. 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.190/2015 të datës 12.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 07.02.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.190/2015 të datës 12.10.2016, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.190/2015 të datës 12.10.2016, të akuzuarin D.M. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, për të cilën gjykata i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin prej 2 (dy) vitesh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, i akuzuari nuk do të kryen ndonjë vepër penale. Është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 100€, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20€ në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e atakuar me ankesë ta ndryshojë dhe të akuzuarit në vend të dënimit të kushtëzuar ti shqiptoj dënim me burg efektiv.

Prokurori i Apelit, me shkresën PPA/II.nr.1565/2016 datë 14.12.2016, ka propozuar që ankesa e prokurorit të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe ndaj të akuzuarit të shqiptohet dënim me burg efektiv.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

- ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt komfor dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzoinin anulimin e tij, dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 12.10.2016 e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, me ankesë prokurori pretendon se Gjykata e shkallës së parë të akuzuarit i ka shqiptuar dënim që nuk është në përputhje me peshën dhe me rrezikshmërinë shoqërore që sjellin këto vepra, duke i mbivlerësuar rrethanat lehtësuese e duke mos marrë parasysh mënyrën dhe pasojat e shkaktuara si dhe mos përshtatjen e shpejtësisë, prandaj edhe konsideron se dënimi i shqiptuar është tejet i butë dhe nuk do të ndikojë dukshëm në vetëdijesimin dhe risocializimin e të akuzuarit.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e Prokurorit për shqiptimin e një dënimi me burg efektiv, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimin në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenin 73 të KPK-së, me ç'rast si rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarit ka vlerësuar pranimin e fajësisë për kryerjen e veprës penale e cila i vihej në barrë, rrethanat e tij personale se i njëjti është njeri familjar-i martuar, mbajtës i familjes, veprën penale e ka kryer nga pakujdesia, rrethana rënduese gjykata pati parasysh faktin se me rastin e këtij aksidenti disa persona kanë pësuar lëndime të rënda trupore e disa të lehta.

Kjo gjykatë, vlerësimin e këtyre të rrethanave relevante të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë e duke vlerësuar edhe faktin se nga kryerja e veprës penale kanë kaluar gati 6 vite si dhe faktin se pasojat e shkaktuara nga kryerja e veprës penale paraqesin elemente të veprës penale e jo rrethana rënduese, del se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, në fakt në ankesë nuk ceket asnjë rrethanë që nuk është vlerësuar më parë nga gjykata e shkallës së parë, e që sipas vlerësimit të kësaj gjykate do të ndikonte që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, pastaj vlen të theksohet se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar rrethanat lehtësuese të theksuara në ankesën e Prokurorit, ku një vlerësim të tillë si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë.

Pra, duke marrë parasysh mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe rrethanat tjera, kjo gjykatë vlerëson se dënimi të cilin të akuzuarit ia ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë në pajtim me dispozitën e neni 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1533/16 me datë 07.02.2017

Bashkëpunëtori profesional
Hysni Ismaili

Kryetari i kolegjit-gjyqtari

1. Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

2. Shqipe Qerimi

3. Ferit Osmani